



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

1391
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 29. 02. 2012

UDHËZIM

Nr. 4, datë 29. 02. 2012

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 45, DATË 19. 12. 2011 "PËR GJENERIMIN
DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, të pikës 3 të nenit 58 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në Udhëzimin nr. 45, datë 19. 12. 2011 "Për gjenerimin dhe dhënie e numrave të matrikullimit", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"2. Studentët e marrin numrin e matrikulimit (NIM) të përbërë nga tre gërma dhe 3 shifrat të kodit të regjistrimit dhe gjashtë shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikulimit është sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi."

2. Pika 5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"5. Çdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga tre gërma dhe tre shifra. Gërma e gjashtë e kodit të regjistrimit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi."

3. Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 që i bashkëlidheshin Udhëzimit nr. 45, datë 19. 12. 2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” zëvendësohet me shtojcën nr. 2 dhe shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.
- II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

MYQEREM TAFAJ

MINISTËR



